

POZICIONI VAKANT: Jurist/e pranë Departamentit Juridik INSIG sh.a Tirane

Kompania e Sigurimeve INSIG sh.a kërkon të punësojë në Drejtorinë Qëndrore, Jurist/e

PËRSHKRIMI I PUNËS

Mbrojtja e shoqërisë në çështjet civile, ku ajo është palë e paditur apo paditëse, sigurimi i asistencës juridike në çështjet administrative, civile, marrëdhëniet e punës, kontratat e biznesit etj, .

PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Hartimi i praktikave për kërkesë- padi, apel kundërshtues, ankime, rekurs, kundër-rekurse, kërkesë për pezullim, ankime të veçanta, prapësime, konkluzione përfundimtare dhe çdo veprim tjetër procedural që mund të dalë gjatë procesit gjyqësor;
- Ndjekja e procesve gjyqësore, për mbrojtjen e interesave të shoqërisë
- Dhënia e asistencës juridike për kontratat e sigurimit, kushtet e produkteve të reja;
- Dhënia e asistencës juridike për marrëdhënien e punës, marrëdhëniet administrative, civile, kontratat e blerjeve etj.
- Përpilimi i marrëveshjeve të ndryshme;
- Vlerësimi juridik i dosjeve të dëmeve , në drejtim të përmbushjes së detyrimeve ligjore,
- Realizimin i detyrave që caktohen nga drejtori i Drejtorisë Juridike.
- Sjellja në përputhje me rregullat e etikës.

KRITERET:

Kandidati duhet e plotesoje kriteret e meposhtme:

- Të ketë kryer arsimin e lartë në degën “Drejtësi”; pranë Universiteteve shtetërore.
- Lloji diplomës: DNP (Diplomë e nivelit të parë) + Master Shkencor në e Drejtë Civile/Publike.
- Eksperiencë pune mbi 3 vite si jurist/e përfaqësues/e në Gjykatë, përpilimin e kërkesëpadive dhe përgatitjen e dokumentacionit;
- Të zotërojnë Gjuhën Angleze në nivel profesional;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, etike dhe bashkëpunimi;
- Njohuri të mira të programeve të paketës Microsoft Office.

Dokumentet që duhet të paraqesin të interesuarit janë:

- Fotokopje të diplomës; • Curriculum Vitae (Cv); • Dëshmi kualifikimi të ndryshme.

Ofrohen kushte të mira pune dhe kontratë e rregullt, sipas legjislacionit në fuqi;

Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV-në e tyre në adresën e email: mhasanaj@insig.com.al.

Afati aplikimit është deri më datë 20.11.2025